



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 3 dhe 4 Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 28. 05. 2020, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

V E N D I M
PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË
BASHKËSI –KKSB-së

Neni 1

Zëvendësimi i anëtarëve të KKSB-së

1.Me këtë Vendim zëvendësohet tre anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të caktuar sipas pikës I të Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSB në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-67926 të datës 22.12.2017 ashtu :

1.1 Z.Xhevdet Bytyqi nga Bashkësia Islame në numrin rendor 3 zëvendësohet nga Mr. Zaim Bahtiu,

1.2 Z.Ylber Reqica nga OJQ "Polis" në numrin rendor 6 zëvendësohet nga Z.Muhamet Qeriqi,

1.3.Rasim Hasani, ish-Drejtor i Drejtoratit për Arsim tani drejtor I DSHP-së në numrin rendor 14 zëvendësohet nga Drejtoresha e Drejtoratit për Arsim Znj. Elmaze Behluli .

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të KKSB-në është i përcaktuar me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSB në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-67926 të datës 22.12.2017.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

15 Nr. -020-19926

Lipjan, më 29. 05. 2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

